



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.4/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit: P....., me seli ne Prishtinë me adres Rr. ....-Gjilan të cilën me autorizim e përfaqëson “C...” L.L.C, kundër debitorëve: “A...” NTP me numër të biznesit .... me adres biznesi Rr. ....pn të cilën e përfaqëson F.H. (Huamarrës-penglënës),debitorëve H.H. me numër të ID. .... në cilësinë e Bashkë huamarrës (Hipotekuese-penglënës),B.H. me numër personal ID .... (dorëzanë) dhe I.H. me numër personal ID ....(Hipotekues) të gjithë nga fshati ... Komuna e Kamenicës, që ka të bëjë me pagesën e kredisë, si objekt i përbarimit, duke vendosur sipas propësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Përparim I. Xhelili P.nr.114/2018 të dt:23.07.2018, mbi caktimin e përbarimit, me dt:31.08.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PABAZUAR propësimi i debitorëve të përbarimit: “A...” NTP me numër të biznesit .... me adres biznesi Rr. ....p.n të cilën e përfaqëson F.H. (Huamarrës-penglënës),debitorëve H.H. me numër të ID. .... në cilësinë e Bashkë huamarrësit (Hipotekuese-penglënës), B.H. me numër personal ID..... (dorëzanë) dhe I.H. me numër personal ID.....(Hipotekues) të gjithë nga fshati ... Komuna e Kamenicës, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit numër P.nr.114/2018 të dt:23.07.2018, i lejuar nga Përbaruesit Privat Përparim I. Xhelili.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore e përbaruesit privat në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Kontratës mbi hipotekën nr.53-002642 si dhe Aktvendimit të zyrës Komunale të Kadastrit në Kamenicë nr..... i datës 04.04.2011 mbi regjistrimin e hipotekës, të cilat dokumente paraqesin dokument përbarues në bazë të nenit 21, 22 të LPP-së.

Kundër propozimit për përbarimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij propësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përbaruesit privat për arsye se nuk qëndroj asnjë nga arsyet që parashihen me LPP-në. Me

tejt të njëjtit kanë shtuar se në rastin konkret në tersi përmbushën kushte ligjore të parapara me nenin 55 të LPP-së, duke pasur parasysh faktin se mes palëve ndërgjyqëse nuk janë shterur të gjitha mjete e brendshme që i posedon kreditori, pra nuk janë kontaktuar fare bashkë huamarrësi dhe garantuesi me peng dhe hipotekë, por për shkak të një vonese të arsyeshme dhe të pranueshme ka ardhur deri të një borxh në vlerë prej 2,297.11 euro, e që është një shifër tejet e ulët në krahasim me obligimin definitiv. Gjithashtu debitorët e përmbartimit pas vlerësimit të propozimit dhe urdhri për përmbartim konsiderojnë se një propozim i tillë është tejet i parakohshëm dhe si i tillë vetëm se e pengojnë debitorin kryesor që të përmbartoj pozitën financiare duke ndodhur në presione të vazhdueshme në këtë procedurë. Tutje të njëjtin kanë deklaruar se ende nuk ka ardhur faza ku duhet të përmbartohet ky borxh sepse shumata e pa përmbartur e kredisë është 20%, e borxhin total që ka arritur për pagesë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat debitorët e përmbartimit i kanë propozuar Gjykatës që të analizoj të gjitha shkresat e lëndës dhe pas shqyrtimit kryesor të aprovoj në tërësi prapësimin si të bazuar dhe urdhrin përmbartimore të shfuqizoj në tërësi.

Në përgjigje në prapësim kreditori ka theksuar se i pretendimi i parë i debitorëve se kreditori nuk i ka shterur të gjitha mjetet është pretendim i pa qëndrueshme për faktin se para se të dërgohet lënda në procedurën e përmbartimit, kreditori ka aprovuar kërkesën e debitorit ashtu që i ka mundësuar ristrukturimin e kredisë ku nga kësti aktual sa ka qenë, debitorit i është zvogëluar kësti mujor, por që edhe pas këtij ristrukturimi të kredisë debitorit ka vazhduar me mos respektim të planit të pagesës. Po ashtu edhe pretendimi tjetër i debitorëve se nuk është njoftuar bashkë huamarrësi, edhe ky pretendim nuk qëndron për faktin se bashkë huamarrësi është njoftuar disa herë se debitorit kryesor vazhdon të këtë probleme me pagesën e kësteve të rregullta, por që i njëjti nuk ka mundur të prodhoj ndonjë zgjidhje të qëndrueshme, andaj për këto arsye kreditori i kishte vazhduar procedurat ligjore. Prandaj qëllimi kryesor i këtij prapësimi është prolongimi i përmbartjes së detyrimit dhe dëmtimi i kreditorit, pasi që pretendimet e ngritura janë të pa bazuara në ligj dhe të pa themelta.

Andaj duke u bazuar në të lartpërmendurat, kreditori i përmbartimit i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimi e debitorit të përmbartimit dhe të vazhdohet procedura përmbartimore.

Gjykata ka vlerësuar dokumentet përmbartimore Kontratës mbi hipotekën nr.53-002642 si dhe Aktvendimit i zyrës Komunale të Kadastrit në Kamenicë nr.H-.... i datës 04.04.2011 mbi regjistrimin e hipotekën, të cilat dokumente mbi hipotekën paraqesin titull ekzekutiv në mbështetje të nenit 21,22 par 1.7 të LPP-së, në bazë të të cilave përmbartuesi privat ka zbatuar përmbartimin, të cilat dokumente përmbartuese përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 par.3 dhe 27 i LPP-së, për të qenë të përmbartueshem dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata, bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së, se nuk janë përmbartur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbartuesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1

dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike  
KPPP.nr.4/2022, dt.31.08.2022

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.